



BASHKIA
TIRANË



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist II, Drejtorja e Koordinimit të Projekteve (Kategoria IV-a).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë:

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë Bachelor;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialist II ka për detyrë si më poshtë:

1. Specialisti i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve varet nga Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve.
2. Specialisti i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve, ka këto detyra kryesore:
 - a. Ndjek të gjithë procesin e zbatimit të projekteve publike miratuar nga Bashkia Tiranë për zhvillimin e qytetit.
 - b. Harton të gjitha kthim përgjigjet e shkresave të deleguara nga Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve.
 - c. Kontrollon ecurinë e projekteve që janë miratuar nga Bashkia Tiranë.
 - d. Mban dosjen me dokumentacionin (korrespondencën zyrtare) mes IMT dhe ALUIZNI-t duke u kujdesur që çdo komunikim të formalizohet me shkrim.
 - e. Zbaton legjislacionin në fuqi lidhur me zbatimin, kolaudimin dhe mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit.

Dokumentat që aplikanti për Specialist II në Drejtorinë e Koordinimit të Projekteve duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë Bachelor (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*), dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 19.01.2023 **ora** 16:30.